



Pranuar / Dorezuar / Prijmjen / Prodato Received / Delivery	09.10.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	6473/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1139/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1139/2023 të datës 04.09.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/ Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 09.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1139/2023 e datës 04.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 01.04.2014 në pozitën “*Inspektor Fitosanitar Kufitar*”, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, më datë 04.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5940/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ndërsa Këshilli me datë 13.09.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5940/2023 të datës 04.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 04.09.2023 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 13.09.2023; Akt Emërimit e datës 01.04.2014 të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për Inspektor Fitosanitar Kufitar i datës 01.06.2011; Vendimin Ref. AUV 010/1/2021 i datës 15.01.2021 për caktimin e zëvendësuesit të Udhëheqësi të Sektorit të Inspektorit Fitosanitar; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin i datës 21.01.2023 dhe 26.01.2022; Vërejtjen me shkrim e datës 07.06.2023; Emailin e datës 25.08.2023 nga ankuesin; Emailin e datës 25.08.2023 nga ankuesi për [] ; Emailin e datës 12.09.2023 nga [] për [] Lista e punonjësve të Shërbimit Fitosanitar Kufitar; Orari i Punës për Insektar Kufitar muaji janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2022; Orari i Punës për insektar Kufitar muaji, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës, konstatoi se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon për diskriminim nga z. [] si Zëvendësues i Udhëheqësit të Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar për shkak të orarit tendencioz për shkak që na dërgon për inspektim me kilometra larg vendbanimit; pretendon se ka kërkuar nga kreu i Departamenti të Burimeve Njerëzore që të filloj procedurën disiplinore ndaj z. [] si Zëvendësues i Udhëheqësi të Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar.

Kolegji i Këshillit marr për bazë që pozita "Inspektor Fitosanitra Kufitar" është pozitë e shërbyesit civil mirëpo për nga specifika dallon për shkak se për këtë pozitë kërkohet që mbajtësi i kësaj pozite të jetë në punë edhe jashtë orarit zyrtar të punës, ditëve të vikendit apo edhe gjatë festave zyrtare, kjo është përcaktuar edhe me përshkrimin e detyrave të punës për këtë pozitë të datës 01.06.2011, kështu që ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me diskriminimin me rastin e caktimit të orarit të punës, Kolegji në bazë të provave materiale respektivisht orarit të punës për vitin 2022 dhe orarit të punës nga janari deri në shtator 2023, konstaton se këtu ankuesi në muajin janar 2022 ka qenë i caktuar në pikën kufitare në Merdare ditën e Merkurë dhe të Enjte nga ora 08:00 deri në orën 16:00 dhe pikën kufitare në Mitrovicë në ditën e Premte dhe të Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, respektivisht katër ditë punë, gjatë orarit për muajin shkurt 2022 ankuesi ka qenë i caktuar në pikën Mitrovicë për ditën e Hënë, Martë, Premte dhe Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsejtë katër ditë punë, gjatë muajit mars 2022, ankuesi ka qenë i caktuar në pikën Mitrovicë për ditën e Hënë, Martë, Premte dhe Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsejtë katër ditë punë, gjatë muajit prill 2022 ankuesi ka qenë i caktuar në pikën Merdare në ditën e Hënë dhe të Martë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, dhe në pikën Mitrovicë për ditën e Merkurë, Enjte dhe Premte nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsejtë pesë ditë, në muajin mars 2022 ankuesi ka qenë i caktuar në pikën Mitrovicë ditën e Merkurë, pikën Prishtina 2 dhe Posta për ditën e Enjte, Premte dhe Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 për gjithsejtë katër ditë, gjatë muajit qershor 2022 ankuesi ka qenë i caktuar në pikën

Mitrovicë për ditën e Hënë dhe e Martë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, dhe pikën Jarinjë ditë e Shtunë prej orës 08:00 deri në orën 16:00 (me thirrje telefonike), gjatë muajit korrik 2022 ankuesi është caktuar në pikën Mitrovicë në ditën e Hënë dhe të Martë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 dhe pinë Prishtina-3 dhe ANP në ditën e Premte dhe Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 për gjithsej katër ditë, për muajin gusht 2022 ankuesi është caktuar në pikën në Jarinjë nga dita e Hënë deri në ditën e Premte nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej pesë ditë, për majin shtator 2022 ankuesi është caktuar në pikën Merdare në ditën e Merkure dhe Enjte nga ora 08:00 deri në orën 16:00, në pikën në Mitrovicë në ditën e Hënë dhe Martë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, në pikën Jarinjë ditën e Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsejtë pesë ditë, gjatë muajit tetor 2022 ankuesi është caktuar në pikën Merdare në ditën e Merkure dhe Enjte nga ora 08:00 deri në orën 16:00, në pikën Mitrovicë në ditën e Hënë dhe Martë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej katër ditë, gjatë muajit nëntor 2022 ankuesi është caktuar në pikën Merdare për ditën e Merkurë dhe Enjte prej orën 08:00 deri në orën 16:00, në pikën Mitrovicë për ditën e Hënë dhe Martë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej katër ditë, gjatë muajit dhjetor 2022 ankuesi është caktuar në pikën Merdare ditën e Merkure dhe Enjte nga ora 08:00 deri në orën 16:00, pikën Mitrovicë ditë e Hënë dhe Martë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 dhe pikën Jarinjë ditë e Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej pesë ditë, gjatë muajit janar 2023 ankuesi është caktuar në pikën Mitrovicë nga dita e Hënë deri në të Shtunën me orar nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej gjashtë ditë, gjatë muajit shkurt 2023 ankuesi është caktuar në pikën në Ferizaj për ditën e Hënë, Marte dhe Merkurë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, në pikën Mitrovicë është caktuar në ditën e Shtunë prej orën 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej katër ditë, gjatë muajit mars 2023 ankuesi është caktuar në pikën Merdare për ditën e Enjte, Premte dhe Shtunë prej orës 08:00 deri në orën 16:00, dhe pikën Mitrovicë në ditën e Hënë dhe Martë prej orës 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej pesë ditë, gjatë muajit prill 2023 ankuesi është caktuar në pikën Prishtina 2 dhe Posta për ditën e Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, si dhe pikën Prishtina 3 dhe ANP për ditën nga e Marte deri të Shtunën nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej gjashtë ditë, gjatë muajit maj 2023 ankuesi është caktuar në pikën Merdare për ditën Enjte, Premte dhe Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, si dhe pikën Mitrovicë për ditën e Hënë, Marte dhe Merkure nga data 15.05.2023 prej orës 08:00 deri në orën 16:00, gjatë muajit qershor 2023 ankuesi nuk është caktuar, gjatë muajit korrik 2023 është caktuar në pikën Merdare për ditën e Hënë, Martë dhe Merkure nga ora 08:00 deri në orën 16:00, pikën Prishtina 2 dhe Posta për ditën e shtunë nga ora 08:00 deri orën 16:00, dhe pikën Prishtina 3 dhe ANP për ditën e Premte dhe Shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej gjashtë ditë, gjatë muajit gusht 2023 ankuesi është caktuar në pikën Merdare për ditën e Hënë, Marte dhe Merkure nga ora 08:00 deri në orën 16:00, në pikën Mitrovicë për ditën e Premte dhe Shtunë prej orës 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej pesë ditë, gjatë muajit shtator 2023 ankuesi është caktuar në pikën Merdare nga dita e Hënë deri në të Premten nga ora 08:00 deri në orën 16:00 me gjithsej pesë ditë.

Kolegji i Këshillit, në bazë të këtij orari të caktuar, konstaton se nuk vërehet ndonjë diskriminim për ankuesin në raport me punëtorët e tjerë për shkak që edhe inspektorët e tjerë janë caktuar qoftë në pika të njëjta apo të ndryshme me ora të njëjtë, mbi këtë bazë nuk vërehet që ka shmangie nga parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar sipas nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në fuqi gjatë kësaj periudhe i cili

përcakton se: "1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë", kështu që ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka ofruar ndonjë provë relevante përmes të cilës do të vërtetohej së është vepruar në mënyrë tendencioze ndaj ankuesit, si rrjedhojë pretendimi i ankuesit është i pa argumentuar.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, i cili pretendon se ka kërkuar nga Udhëheqësi i Departamenti të Burimeve Njerëzore që të filloj procedurën disiplinore ndaj z. si Zëvendësues i Udhëheqësi të Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka ofruar ndonjë provë relevante përmes të cilës do të dëshmohej se ka kërkuar një gjë të tillë po ashtu edhe përmes përgjigjes në ankesë të datës 13.09.2023 jemi njoftuar se Njësia e Burimeve Njerëzore nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për inicim të procedurës disiplinore. Referuar kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është shfuqizuar sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i cili është i aplikueshëm nga data 26.09.2023, e që me nenin 59 paragrafi 3 janë paraparë procedurat e fillimit të procedurës disiplinore, në këtë rast edhe ky pretendim i ankuesit është i pabazuar pasi që nuk ka argumentuar pretendimin e tij me asnjë prove konkrete.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1139/2023, datë 09/10/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.